



Regjistri Elektronik për Njoftimet  
dhe Konsultimet Publike

## Projektvendim për miratimin e Strategjisë së Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat 2020-2024 dhe Planit të Veprimit për periudhën 2020-2022

Ministria e Brendshme

Postuar më: 24.03.2020

Projektvendimi “*Për miratimin e Strategjisë së SHÇBA-së 2020 – 2024 si dhe planit të veprimit për periudhën 2020 – 2022*” është një dokument i nivelit strategjik afatmësëm, që hartohet për herë të parë.

Ai pasqyron politikat shtetërore për zhvillimin e këtij shërbimi të rëndësishëm, të ngritur posaçërisht nga ligji për të mbrojtur integritetin dhe veprimtarinë e Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe punonjësit e Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, punonjësve të tyre dhe të drejtat e liritë e shtetasve.

Qëllimi i këtij dokumenti është të modelojë organizimin dhe funksionimin e SHÇBA-së për të zhvilluar e përafuar më tej standardet, me ato të vendeve perëndimore dhe ndërtuar një shërbim publik përfaqësues e me integritet të lartë, të besueshëm nga opinioni publik, transparent dhe efikas për mbrojtjen e ligjshmërisë, interesave të shtetit e komunitetit; si dhe të përcaktojë vizionin, prioritetet e objektivat strategjike me politikat dhe alternativat e zhvillimit për të ardhmen.

Dokumenti materializon politiken shtetërore për SHÇBA-në.

Ai u vjen në ndihmë :

- a. organeve vendimmarrëse për të realizuar politikat në zhvillimin institucional dhe burimeve të nevojshme;
- b. drejtuesve të shërbimit për zhvillimin e standardeve të shërbimit dhe rritjen e efikasitetit në kryerjen e detyrave;
- c. institucionet ligjzbatuese që përfshihen në objektin e veprimtarisë së këtij shërbimi;
- d. punonjësve të shërbimit, për tu organizuar në kryerjen e detyrave;
- e. aktorëve të tjerë shtetërorë e shoqërorë që i lidh veprimtaria;
- f. opinionit publik, i cili është shumë i interesuar.

### Dokumenta:

- [Draft strategjia](#)
- [Draft Plani i Veprimit](#)
- [Relacioni shpjegues](#)

